



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:086349

Datë: 28.06.2024

Numri i dokumentit: 05874837

KPPP.nr.514/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtarja Verona Dibra, në çështjen përmbartimore të kreditorit Kompania Rajonale e Mbeturinave “Pastrimi”, SH.A., me NUI: 811276957, me seli në Prishtinë, rruga “Bill Klinton”, p.nr., kundër debitorit “Albanos”, me seli në Podujevë, rruga “Skënderbeu” pn., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Ali Ajeti, avokat nga Podujeva, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.265/20 të datës 25.02.2020, të Përmbartuesit Privat Eset Murati, me seli në Prishtinë, jashtë seancës, me datë 28.06.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

PRANOHET si i bazuar prapësimi i debitorit “Albanos”, dhe ANULOHET Urdhri Përmbartimor P.nr.265/20 i datës 25.02.2020, i lëshuar nga Përmbartuesi Privat Eset Murati.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Kompania Rajonale e Mbeturinave “Pastrimi”, SH.A., ka caktuar urdhrin përmbartimor P.nr.265/20 të datës 25.02.2020, duke lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit të besueshëm Kartela e Konsumatorit, me ID Nr. 113600, nga periudha kohore 01.01.2009 deri më 31.01.2020, me të cilin e ka urdhëruar debitorin “Albanos”, që në afatin prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij urdhri t’ia paguaj kreditorit borxhin prej 1,751.41 €, me kamatë prej 8 %, nga dita e lejimit të përmbartimit e deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet përmbartimore, nën kërcënimin e përmbartimit të dhunshëm, me ndalimin e mjeteve monetare të cilat i ka debitori në llogaritë bankare dhe bartjen e shumës përkatëse në llogarinë bankare të kreditorit, me ndalimin e mjeteve

në të ardhura personale, si dhe me regjistrimin, vlerësimin, sekuestrimin dhe shitjen e sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme të debitorit, deri në vlerën e borxhit.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, përmes përfaqësuesit të autorizuar, ka kundërshtuar urdhrin për lejimin e përmbarimit duke theksuar se nuk mbështetet në dokument të besueshëm, për shkak se nuk ka ndonjë provë se debitori ka pranuar faturë në emër të shërbimit të pastrimit nga viti 2000 e tutje. Më tutje ka shtuar se nuk janë plotësuar kushtet ligjore për t'u lejuar përmbarimi dhe se kërkesa e kreditorit është parashkruar në kuptim të nenit 341 të Ligjit Nr. 04/-077 Për Marrëdhëniet e Detyrimeve (tutje LMD), sepse që nga viti 2009 e deri në vitin 2020 kur kreditori pretendon se është kryer shërbimi e deri më tani kanë kaluar më shumë se katërmëdhjetë vite. I ka propozuar gjykatës që të aprovet prapësimi i debitorit, të anulohet urdhri përmbarimor, si dhe të detyrohet kreditori që debitori t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës përmbarimore sipas tarifës së Odës së Avokatëve të Kosovës (TOAK).

Kreditori në përgjigjen në prapësim të paraqitur brenda afatit ligjor, ka kundërshtuar pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim duke theksuar se në rastin konkret debitori është biznes dhe jo klient shtëpiak (amvisëri), ashtu që vlejné dispozitat e nenit 353 të LMD-së. Ka shtuar se në këtë çështje kemi të bëjmë me marrëdhënie detyrimore në mes të kreditorit si ofrues i shërbimeve dhe debitorit si biznes në cilësi të marrësit të shërbimeve, e të cilat nuk janë të rregulluara dhe as të tarifuara ngjashëm me shërbimet e kryera për nevojat shtëpiake. I ka propozuar gjykatës që të refuzohet në tërësi prapësimi, si dhe të obligohet pala debitore që të bëjë pagesën e borxhit ndaj kreditorit, duke përfshirë edhe të gjitha shpenzimet tjera të krijuara nga kjo procedurë.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim të kreditorit si dhe vlerësimin të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore (tutje LPP), gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar dhe se urdhri përmbarimor duhet të anulohet, për shkaqet si në vijim:

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa në par.1 nën par. 1.2 të po këtij neni, si dokument i besueshëm sipas ligjit konsiderohen: *“ekstraktet e verifikuara nga librat afariste për pagesat e shërbimeve komunale të furnizimit me ujë, energji elektrike dhe*

bartjen e mbeturinave”, ndërsa me nenin 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se “Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbartim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbartjes së detyrimit monetar”.

Gjykata vlerëson se Kartela e Konsumatorit, me ID Nr.113600, në bazë të së cilës është lejuar propozimi për përmbartim, nuk i plotëson kushtet e përcaktuara ligjore për të qenë dokument i besueshëm sipas dispozitave të nenit 29 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 të LPP-së, meqenëse në këtë dokument nuk është përcaktuar saktë objekti i detyrimit, përkatësisht nuk janë të përshkruara shërbimet të cilat kanë qenë objekt i ekstraktit/kartelës së konsumatorit dhe nuk mund të konstatohet se për cilat periudha kohore është kërkuar përmbartja e borxhit nga debitorit.

Gjykata deri te ky vlerësim erdhi pasi që me propozimin për përmbartim kreditori ka kërkuar përmbartjen e borxhit në shumën prej 1,751.41 €, për periudhën prej datës 01.01.2009 deri me datë 31.01.2020, ndërsa në Kartelën e Konsumatorit me ID Nr.113600 tek përshkrimi “të mbartura” figuron shuma prej 783.35 €, mirëpo nuk është paraqitur periudha kohore për të cilën është krijuar ky borxh, përkatësisht nuk mund të vërtetohet se si ka ardhur deri tek borxhi i kërkuar dhe si rrjedhë ky dokument nuk pasqyron qartë detyrimin që rrjedh nga i njëjti dhe nuk përmban atributet e një dokumenti të besueshëm.

Gjykata i vlerësoi pretendimet tjera të kreditorit, mirëpo gjeti se të njëjtat nuk mund të jenë objekt shqyrtimi i procedurës përmbartimore prandaj dhe nuk mund të vlerësohen në këtë procedurë, ngase kjo procedurë i nënshtrohet parimit të formalitetit rigoroz, në bazë të cilit nuk lejohet vlerësimi i rrethanave tjera, përpos vlerësimit të elementeve formale të dokumentit në bazë të cilit është lejuar përmbartimi, si dhe përshtatshmërisë së vendimit si objekt përmbartimi.

Prandaj, duke u bazuar në të lartcekurat gjykata vlerëson se në rastin konkret dokumenti i besueshëm mbi të cilin mbështetet propozimi për përmbartim, e mbi bazën e të cilit Përmbartuesi Privat ka lejuar përmbartimin nuk kanë tipare të përmbartueshmërisë, dhe si rrjedhë edhe urdhri i lejuar nga ana e përmbartuesit privat duhet të anulohet.

Gjykata në kuptim të nenit 71 dhe 73 të LPP-së, si dhe nenit 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.514/24 datë 28.06.2024

Gjyqtarja
Verona Dibra

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.